



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 638/20
645/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga grupet e operatorëve ekonomik: OE “Drini Company sh.p.k” & Berisha Com sh.p.k - Prizren dhe OE “DT Group sh.p.k & Florida & Horn sh.p.k & Co Kosova” sh.p.k - Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku janë rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik: Company Murseli sh.p.k, N.t.sh. Victory Com- Kaçanik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve, Pjesa e I-rë- Mirëmbajtja e rrugëve dimërore urbane”, me numër të prokurimit: 632-19-7809-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-KK- Gjakovë, më datën: 14.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, si pjesërisht të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: OE “Drini Company sh.p.k” & Berisha Com sh.p.k - Prizren dhe OE “DT Group sh.p.k & Florida & Horn sh.p.k & Co Kosova” sh.p.k - Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë - Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane”, me numër të prokurimit: 632-19-7809-2-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- KK Gjakovë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë - Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane”, me numër të prokurimit: 632-19-7809-2-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- KK Gjakovë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konfirmon dispozitat ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e OE “Drini Company sh.p.k”&Berisha Com sh.p.k -Prizren dhe OE “DT Group sh.p.k & Florida & Horn sh.p.k & Co Kosova” sh.p.k-Gjakovë,i aprovohen si pjesërisht të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohen operatorët ekonomik ankues OE “Drini Company sh.p.k”&Berisha Com sh.p.k -Prizren dhe OE “DT Group sh.p.k & Florida & Horn sh.p.k & Co Kosova” sh.p.k-Gjakovë, që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues: “Drini Company sh.p.k”&Berisha Com sh.p.k -Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me numër 638/20 me datë 07.09.2020 dhe “DT Group sh.p.k & Florida & Horn sh.p.k & Co Kosova” sh.p.k-Gjakovë ka deponuar ankesën me nr. 645/20 me datë 08.09.2020 , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku janë rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik: Company Murseli sh.p.k, N.t.sh. Victory Com- Kaçanik , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:”Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve, Pjesa e I-rë- Mirëmbajtja e rrugëve dimërore urbane”, me numër të prokurimit: 632-19-7809-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-KK- Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues për OE OE “Drini Company sh.p.k”&Berisha Com sh.p.k -Prizren, ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 24,56, 59, 60, 64, 66, dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik si dhe në kundërshtim me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik
- Autoriteti kontraktues për “DT Group sh.p.k & Florida & Horn sh.p.k & Co Kosova” sh.p.k-Gjakovë ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 par.1, nenin 6 par. 2, nenin 7 par. 1 dhe 4, nenin 51, nenin 52 par. 4, nenin 56, nenin 59 par. 2 dhe 4, nenin 60 par.2 dhe nenin 72 par.3 të Ligjit për Prokurimin Publik

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 25.09.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues i sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Drini Company sh.p.k”&Berisha Com sh.p.k -Prizren

Përgjigje në pretendimin nr. 1

Lidhur me pretendimin ankimor se OE Victory Com ka paraqitur referencë nga kompania Grand Construction në vlerë 150,000€, OE pretendon se kjo referencë nuk ka situacion mbi kryerjen e punimeve, nuk ka fletëpagesa. Theksojmë se për këtë referencë OE ka ofruar kontratën me kompaninë Grand Construcion, mirëpo as në këtë kontratë nuk ka informata, si numri prokurimit, situacionet mbi kryerjen e punimeve, periudha apo përqindja e punëve që është kryer nga OE Victory. Dhe nuk dihet nëse OE është deklaruar si nënkontraktor në kontratën bazë me KK Kaçanik.

Bazuar në këtë që u cek më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar dhe se AK duhet të verifikoj të dhënat e shënuara më lart.

Përgjigje në pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimin ankimorë për referencën e lëshuar nga kompania Gjeo Projekt për largimin e borës dhe shpërndarje të kripës në punishten e kompanisë Gjeo Projekt, të cilën e konteston OE ankues, vlerësojmë se pretendimi ankimor është i bazuar dhe se AK duhet të kërkoj dëshmi mbi realizimin e këtyre punëve, dëshmi si dëshmi transaksione bankare për pagesat e bëra, pasi kemi të bëjmë me kontratë ne mes të OE-ve privat e të cilat kontestohen nga OE ankues.

I njëjti pretendim ankimorë vlen edhe për referencën e lëshuar nga kompania “Art Konstruksion”, nuk ka dëshmi për punët kryera, si fatura, dëshmi për pagesa etj.

Përgjigje në pretendimin nr.3

Lidhur me pretendimin ankimorë se pronarët e Grand Construcion dhe Murseli Company mes vete janë familjarë dhe se kontrata mes Grand Construcion dhe Victory Com (ku Vicotry Com dhe Murseli janë anëtar të grupit) është fiktive, sqarojmë se eksperti shqyrtues nuk ka kompetencë e as kapacitet teknik për të shqyrtuar një pretendim të tillë ankimorë, dhe vlerësojmë se për çështje të tilla OE ankues do duhej ti drejtohet organeve kompetente.

Përgjigje në pretendimin nr.4

Lidhur me pretendimin ankimorë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar listën me 20 punëtor ndërsa në listë të ATK-së I ka vetëm 10 punëtor, është e vërtetë se në listën e ATK-së (lista e ATK është e vitit 2018) OE ka vetëm 10 punëtor , me gjithë këtë duhet theksuar se lista e ATK-së nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është pjesërisht i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.5

Lidhur me pretendimin ankimorë sa i përket pajisjeve/makinerisë së OE të rekomanduar për kontratë, OE ankues i referohet vendimit të OSHP-së nr. 939-952/19.

Duhet të theksojmë se me vendim të OSHP-së nr. 933-952/19 në cilin rast OE Victory&Murseli kanë qenë ankues, pretendimi i tyre ankimorë është vlerësuar si i pabazuar sa i përket pajisjeve/makinerisë ashtu siç pretendon tani OE ankues, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.6

Sa I përket pretendimin ankimorë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklaratë për specifika teknike, theksojmë se një deklaratë e tillë nuk ka qenë kërkesë në dosje të tenderit andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.7

Lidhur me pretendimin ankimorë kundrejt OE D&T Group, OE ankues thekson se pajtohen me eliminimin e këtij OE pasi i njëjti nuk ka ofrua dëshmi për kontrata të natyrës së ngjashme për tri vitet e fundit në vlerë prej 350,000€.

Theksojmë se vendimi i OSHP-së me rastin e kthimit të lëndës në rivlerësim e ka obliguar AK-në të marr parasysh kontratat për punë të ngjashme, dhe nëse është e nevojshme të kërkoj sqarime shtesë për situacionet e përfunduara se a e arrin vlerën e kërkuar 350,000€.

Me rastin e rivlerësimit AK. kanë vlerësuar se OE DT Group nuk e arrijnë vlerën e kërkuar për punë të ngjashme 350.000€.

Lidhur me këtë çështje si ekspert shqyrtues kemi dhënë përgjigje në raportin e datës 10.06.2020 me nr. 279/20.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: “DT Group sh.p.k & Florida & Horn sh.p.k & Co Kosova” sh.p.k-Gjakovë

Përgjigje në pretendimin nr.1

Pretendimi i parë dhe kryesor ankimorë i OE D&T Group është arsyeja e eliminimit nga AK, se I njëjti nuk

ka ofruar dëshmi për punë të ngjashme në tri vitet e fundit në vlerë 350.000€.

Në ankesën e tij me nr.,..645/20 OE ankues ka veçuar 5 referenca me të cilat pretendon se plotësohet kërkesa e AK-së, dhe ato janë si në vijim :

1. Referenca me Komunën e Gjakovës "Mirëmbajtja e Autorrugëve-Lot 1" vlera (47,300 +30% e vleres) total 61,490.00 Euro;
2. Referenca e kompanisë FLORIDA sh.p.k, "Mirëmbajtja rutinë dhe dimërore në aksin rrugor Bajram Curr-Fierzë" në vlerë 205,000.00 Euro;
3. Referencat e Referencat e NOTI BETON "Ndërtimi i kolektorit betonarme dhe kanalizimi fekal" Vlera 412,376.72 Euro;
4. Referenca e Komunës së Gjakovës "Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni lot II" në vlerë 76,288.00, dhe
5. Kontrata "Sanimi dhe Ndërtimi i pendave dhe kanaleve të ujitjes" e vitit 2018-2019 referenca e dorëzuar pranë AK Komuna e Gjakovës 77,847.00 Euro.
- 6.

Vlerësojmë se përveç dy referencave të para, kontratat tjera si : "Ndërtimi i kolektorit betonarme", "Ndërtimi i rrugëve me kubëza", "Sanimi dhe ndërtimi e pendave dhe kanaleve të ujitjes" nuk janë kontrata të natyrës së ngjashme me "Mirëmbajtje dimërore të rrugëve".

Vendimi i OSHP-së me rastin e kthimit të lëndës në rivlerësim e ka obliguar AK-në të marr parasysh kontratat për punë të ngjashme, dhe të kërkoj sqarime shtesë për situacionet e përfunduara se a e arrijnë vlerën e kërkuar 350,000€.

Me rastin e rivlerësimit AK kanë vlerësuar se OE DT Group nuk e arrijnë vlerën e kërkuar për punë të ngjashme 350.000E.

Theksojmë se lidhur me këtë çështje kemi dhënë përgjigje në raportin e datës 10.06.2020 me nr. 279/20.

Përgjigje në pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimet ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, për referencat e lëshuara nga kompani private për OE të rekomanduar për kontratë, janë pretendime të njëjta sikurse të OE të parë ankues, dhe për mos ti përsëritur të njëjtat jemi përgjigjur tek përgjigjet 1, 2 dhe 3 të ankesës 638/20.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues të aprovohen pjesërisht të bazuara, ndërsa të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 25.09.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, vetëm e ka konfirmuar pranimin e ekspertizës por nuk e ka njoftuar OSHP-në, se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, OE “Drini Company sh.p.k”&Berisha Com sh.p.k -Prizren , nuk e ka njoftuar OSHP-në, se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik , “DT Group sh.p.k & Florida & Horn sh.p.k & Co Kosova” sh.p.k-Gjakovë , nuk e ka njoftuar OSHP-në, se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 14.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, sqaron se ankesa është parashtuar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Drini Company sh.p.k”&Berisha Com sh.p.k - Prizren

Lidhur me pretendimin ankimor se OE Victory Com ka paraqitur referencë nga kompania Grand Construction në vlerë 150,000€, OE pretendon se kjo referencë nuk ka situacion mbi kryerjen e punimeve, nuk ka fletëpagesa. Paneli sqaron se për këtë referencë OE ka ofruar kontratën me kompaninë Grand

Construcion, mirëpo as në këtë kontratë nuk ka informata, si numri prokurimit, situacionet mbi kryerjen e punimeve, periudha apo përqindja e punëve që është kryer nga OE Victory. Dhe nuk dihet nëse OE është deklaruar si nënkontraktor në kontratën bazë me KK Kaçanik. Paneli shqyrtues e kualifikon si të bazuar pretendimin ankimor dhe obligon AK-në që gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë nga AK lidhur me referencën në fjalë konform nenit 72 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin ankimorë për referencën e lëshuar nga kompania Gjeo Projekt për largimin e borës dhe shpërndarje të kripës në punishten e kompanisë Gjeo Projekt, të cilën e konteston OE ankues, paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar dhe se AK duhet të kërkoj dëshmi mbi realizimin e këtyre punëve, si dëshmi transaksione bankare për pagesat e bëra, pasi kemi të bëjmë me kontratë ne mes të OE-ve privat e të cilat kontestohen nga OE ankues. Po ashtu, AK obligohet që gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime edhe për referencën e lëshuar nga kompania "Art Konstruksion", pasi që nuk ka dëshmi për punët kryera, si fatura, dëshmi për pagesa etj, andaj AK konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë nga operatori ekonomik.

Lidhur me pretendimin ankimorë se pronarët e Grand Construcion dhe Murseli Company mes vete janë familjarë dhe se kontrata mes Grand Construcion dhe Victory Com (ku Vicotry Com dhe Murseli janë anëtar të grupit) është fiktive, paneli shqyrtues sqaron se eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues nuk janë organe përkatëse për të vërtetuar pretendime të tilla dhe se për këtë OE mund ti drejtohet atyre organeve.

Lidhur me pretendimin ankimorë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar listën me 20 punëtor ndërsa në listë të ATK-së I ka vetëm 10 punëtor, është e vërtetë se në listën e ATK-së (lista e ATK është e vitit 2018) OE ka vetëm 10 punëtor, me gjithë këtë duhet theksuar se lista e ATK-së nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit andaj paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimorë është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimorë sa i përket pajisjeve/makinerisë së OE të rekomanduar për kontratë, OE ankues i referohet vendimit të OSHP-së nr. 939-952/19. Paneli shqyrtues sqaron se në vendimin nr. 933-952/19 në cilin rast OE Victory&Murseli kanë qenë ankues, pretendimi i tyre ankimorë është vlerësuar si i pabazuar sa i përket pajisjeve/makinerisë ashtu siç pretendon tani OE ankues, andaj si i tillë ky pretendim ankimor është çështje e gjykuar dhe vlerësohet si i pabazuar.

Sa i përket pretendimin ankimorë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklaratë për specifika teknike, paneli shqyrtues sqaron se një deklaratë e tillë nuk ka qenë kërkesë në dosje të tenderit andaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimorë kundrejt OE "D&T Group", OE ankues thekson se pajtohen me eliminimin e këtij OE pasi i njëjti nuk ka ofruar dëshmi për kontrata të natyrës së ngjashme për tri vitet e fundit në vlerë prej 350,000€.

Në vendimin e OSHP-së me rastin e kthimit të lëndës në rivlerësime ka obliguar AK-në të marr parasysh kontratat për punë të ngjashme, dhe nëse është e nevojshme të kërkoj sqarime shtesë për situacionet e përfunduara se a e arrin vlerën e kërkuar 350,000€. Me rastin e rivlerësimit AK kanë vlerësuar se OE DT Group nuk e arrijnë vlerën e kërkuar për punë të ngjashme 350.000€.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: "DT Group sh.p.k & Florida & Horn sh.p.k & Co Kosova" sh.p.k-Gjakovë

Lidhur me pretendimin ankimor të OE D&T Group që është arsyeja e eliminimit nga AK, se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi për punë të ngjashme në tri vitet e fundit në vlerë 350.000€.

Në ankesën e tij me nr. 645/20 OE ankues ka veçuar 5 referenca me të cilat pretendon se plotësohet kërkesa e AK-së: Referenca me Komunën e Gjakovës "Mirëmbajtja e Autorrugëve-Lot 1" vlera (47,300 +30% e vlerës) total 61,490.00 Euro; Referenca e kompanisë FLORIDA sh.p.k, "Mirëmbajtja rutinë dhe dimërore në aksin rrugor Bajram Curr-Fierzë" në vlerë 205,000.00 Euro; Referencat e Referencat e NOTI BETON "Ndërtimi i kolektorit betonarme dhe kanalizimi fekal" Vlera 412,376.72 Euro; Referenca e Komunës së Gjakovës "Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni lot II" në vlerë 76,288.00, dhe Kontrata "Sanimi dhe Ndërtimi i pendave dhe kanaleve të ujitjes" e vitit 2018-2019 referenca e dorëzuar pranë AK Komuna e Gjakovës 77,847.00 Euro.

Paneli shqyrtues vlerëson se përveç dy referencave të para, kontratat tjera si: "Ndërtimi i kolektorit betonarme", "Ndërtimi i rrugëve me kubëza", "Sanimi dhe ndërtimi e pendave dhe kanaleve të ujitjes" nuk janë kontrata të natyrës së ngjashme me "Mirëmbajtje dimërore të rrugëve". Me vendimin e OSHP-së me rastin e kthimit të lëndës në rivlerësim e ka obliguar AK-në të marr parasysh kontratat për punë të ngjashme, dhe të kërkoj sqarime shtesë për situacionet e përfunduara se a e arrijnë vlerën e kërkuar 350,000€. Me rastin e rivlerësimit AK kanë vlerësuar se OE DT Group nuk e arrijnë vlerën e kërkuar për punë të ngjashme 350.000E.

Paneli shqyrtues sqaron se pretendimet ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, për referencat e lëshuara nga kompani private për OE të rekomanduar për kontratë, janë pretendime të njëjta sikurse të OE të parë ankues, dhe janë sqaruar më lartë.

Paneli shqyrtues vlerëson se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit AK nuk ka vepruar konform dispozitave të LPP-së më saktësisht nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform dispozitave të nenit 59 të LPP-së. Paneli shqyrtues obligon AK-në që gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 72 për referencat dhe pikët ku paneli shqyrtues ka konstatuar se duhet të ipen sqarime shtesë.

Paneli shqyrtues vlerëson se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Kuvendi Komunal i Gjakovës

1x1 OE ankues- OE "Drini Company sh.p.k"&Berisha Com sh.p.k –Prizren

1x1 OE"DT Group sh.p.k & Florida & Horn sh.p.k & Co Kosova" sh.p.k-Gjakovë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.